



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**NDERMARRJA KOMUNALE PLAZH
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. ____ prot.

Durres më, _____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE ASFALTO-BETON

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT: 14213000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 050 000 (dy milion e pesedhjetë mijë)leke paTvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Komunale Plazh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin citohet: Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend

të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare , 2020, 2021,2022, të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raportin negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Kapacitet e nevojshme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

- Në pronesi (për fabriken e asfaltit duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronesinë)
- Të mara me qira (ku do të vërtetohen të dhënat e pronesisë të fabrikës prodhuese të asfaltit)
- Kontrata noteriale furnizimi nga subjekti prodhues (ku do të vërtetohen të dhënat e pronesisë të fabrikës prodhuese të asfaltit)

Sqarim: Për impiantin e asfaltit në pronesi duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore lëshuar nga QKL, fotot, vendodhja e impiantit, karte teknologjike për prodhim asfaltobetonit.

Në rast të marrjes me qira ose kontrate furnizimi kjo kërkesë për impiantin e asfaltit në pronesi duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore lëshuar nga QKL, fotot, vendodhja e impiantit, karte teknologjike për prodhim asfaltobetonit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ç.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Vendosja e këtyre kriterëve referuar dhe legjislacionit në fuqi janë të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 “**Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor**” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Sasia e mallit qe kerkohet siapas tebeles se meposhtme

SASIA E MALLIT

Nr	Emertimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
	Analiza teknike				
1	Emulsion bitumi	litra	1290		
2	Binder me granil guri kave	ton	110.4		
3	Asfaltobeton me zall e rere lavatriçe	ton	75.2		
4	Transport	Ore pune	5		
	TOTALI PA TVSH				
	TVSH				
	TOTALI ME TVSH				

LËVRIMI I MALLIT

Të gjithë artikujt do të sillen brënda **7 ditëve** nga lidhja e kontratës, në Ndermarrjen Komunale Plazh, Lagja 13 , Rruga Dhimiter Kraja, Plazh Durres, ku do te merren ne dorezim nga komisioni per marrjen ne dorezim te mallit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Standarti i kerkuar i asfaltobeton percaktohet:

Mbeshtetur ne Vendimin nr 216 date , 13.04.2023, “Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim”.

- SSH EN 13108-1 Përzierje bituminoe
- SSH EN 13043:2002 / AC:2004 Agregate per perzierje bituminoze dhe per trajtimin e siperfaqeve te rrugëve, te fushave te aviacionit dhe siperfaqeve te tjera te trafikut.

Kjo te vertetohet me paraqitjen e Raport Testimeve dhe Recetat perkatese, per sa me siper. Sipas kartes teknologjike, per prodhim asfalto betoni dhe raportin perkates sipas nenit 43 pika 2 te VKM nr 612 date 05.09.2012 per dispozitat zbatuese te ligjit „Per akcizat“, kjo sipas VKM nr 434 date 20.05.2015,“Per percaktimin e normativave per Firot, Humbjet, Demtimet dhe Skarcot gjate prodhimit, Magazinimit, Transportimit etj. Te njohura per qellime fiskale pika 1; 7;8.

Recetat perkatese per asfalto beton(tapet) eshte:

Granil guri 5-10 mm	40% - 50%
Rere e zeze lumi 0-5 mm	30% - 40%
Rere e bardhe guri 0-5 mm	15% - 25%
Bitum	5.2% - 5.5% te totalit te inerteve

Recetat perkatese per binder eshte:

Granil guri 5-10 mm	20% - 30%
Rere e zeze lumi 0-5 mm	20% - 25%
Rere e bardhe guri 0-5 mm	10% - 20%
Bitum	4% - 4.7% te totalit te inerteve
Granil lumi 10-25 mm	20% - 30 %

Mënyrat për për llogaritjen e vlerës së prokurimit:

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”. (i ndryshuar), sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Si perfundim fondi limit u analizua dhe u percaktua sipas Vendimin nr 216 date , 13.04.2023, “Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punes ngritur me urdher nr 379, date 02.10.2024, miratuar nga titullari i AK, bazuar ne parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhenenit 36, të LPP(i ndyshuar), si dhe nenit 42 dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë

19.05.2021, “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik(i ndryshuar)”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Afati i levrimit: 7 dite nga data e lidhjes se kontrates.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

Blerina Gremi

Gabriela Agolli

Enkelejda Fetahi